Durrës/ Kanosën me armë zjarri një 44-vjeçar, arrestohen 2 persona! I sekuestrohen 3 makina, kallashnikov, pistoletë dhe një radio e lidhur me policinë e Durrësit (EMRAT)

Në Durrës, Policia ka finalizuar operacionin policor të koduar "Intervention", duke parandaluar një ngjarje kriminale dhe vënë në pranga tre shtetas. Ata janë arrestuar për kanosje me armë zjarri ndaj një 44-vjeçari, për motive të dobëta.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
21 Janar, 10:15 | **Përditësimi: 21 Janar, 10:28**

Share

Në Durrës, Policia ka finalizuar operacionin policor të koduar "Intervention", duke parandaluar një ngjarje kriminale dhe vënë në pranga tre shtetas. Ata janë arrestuar për kanosje me armë zjarri ndaj një 44-vjeçari, për motive të dobëta.

Njëri prej të arrestuarve ka precedent kriminal për vjedhje me armë. Gjatë operacionit janë sekuestruar 3 armë zjarri, përfshirë një kallashnikov dhe pistoleta, municion luftarak, si dhe 3 automjete, njëri prej të cilëve i blinduar. Po ashtu, është sekuestruar një radio e lidhur me kanalet e komunikimit të DVP Durrës, e cila ishte në posedim të njërit prej të arrestuarve, i cili kishte precedent kriminal.

> *'Konkretisht, në kuadër të operacionit policor të koduar "Intervention", janë vënë në pranga shtetasit Y. M., 40 vjeç, B. R., 30 vjeç dhe B. C., 30 vjeç, të tre banues në Tiranë, pasi dyshohet se për motive të dobëta, kanë kanosur me armë zjarri, një shtetas 44 vjeç.', thotë policia.*

LEXO EDHE:
Zyrtare/ Teuta shkarkon Edi Martinin, durrsakët gjejnë trajnerin e ri

Operacioni ka nisur menjëherë pas njoftimit për kanosjen në rrugën "Pavarësia", ku shërbimet e Stacionit të Policisë Plazh, në bashkëpunim me Seksionin Operacional dhe Forcën e Posaçme "Shqiponja" të DVP Durrës, kanë ndërhyrë shpejt dhe kanë arrestuar autorët në flagrancë.

> *'Nga kontrolli në automjetin e blinduar të 40-vjeçarit u gjeten 2 armë zjarri (kallashnikov dhe pistoletë). Më tej, nga kontrolli fizik ndaj këtij shtetasi, u konstatua se mbante dhe 1 radio të lidhur me kanalet e komunikimit të DVP Durrës. Në vijim të operacionit "Intervention", nga kontrolli në banesën e babait të shtetasit të arrestuar B. R., u gjet 1 armë zjarri pistoletë.'*

Të arrestuarit janë Ylli Murati (40 vjeç), Bajram Roçi (30 vjeç) dhe Bekim Çera (30 vjeç), të gjithë banues në Tiranë. Materialet procedurale janë dorëzuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme.

Ylli Murati është emër i njohur për drejtësinë. Murati ka qenë pjesë e një grabitjeje të 20 mijë eurove në një autobus të linjës Itali-Vlorë, më datë 25 shtator të vitit 2019. Shuma e 20 mijë eurove i përkiste dy udhëtarëve të kësaj linje dhe përveç Ylli Muratit pjesë e grabitjes ishin dhe dy persona të tjerë.

G.K/Shqiptarja.com

TAG: Durres | armembajtje pa leje | kanosje me armë | ylli murati | Bajram Roci | Bekim Cera

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 21 Janar, 08:38
14 vite nga vrasja e 4 protestuesve, do bëjë SPAK drejtësi për 21 janarin?
Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Trafiku i rënduar në Durrës, Bashkia kufizon hyrjen në qytet të furgonëve që shpërndajnë mallra
Aldo Mustafa
21 Janar, 13:14

Eventi i madh i Manchester City, Shqipëria përfaqësohet në Abu Dhabi me 'Dyrrah Cityn'! Mundësi për talentet e rinj
20 Janar, 15:15

Aksident në aksin Tiranë-Durrës/ Automjeti i tonazhit të rëndë humb kontrollin dhe përplaset me trafik ndarësen
20 Janar, 10:21

Durrës/ Dy vetura përplasen tek ish-'Kënetë', përfundon në kanal mjeti ku udhëtonin 2 të mitur! Tre të plagosurit në spital (VIDEO)
Aldo Mustafa
19 Janar, 18:27

Vidhte pjesë makinash, arrestohet 21-vjeçari në Tiranë! Në banesë i gjendet pistoletë (EMRI +VIDEO)
19 Janar, 11:18

Krujë/ Policia kontrolle në akset kryesore të rrethit, objektiv janë automjetet me xhama të blinduara dhe ndalimi i personave në kërkim
17 Janar, 20:17

Shiste lëndë narkotike në Durrës, arrestohet 35 vjeçari i shpallur në kërkim (EMRI)
17 Janar, 14:08

Durrës/ E ngarkuara e SHBA-së takim me ministrin Vengu dhe kundëradmiralin Agastra, viziton Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare
16 Janar, 20:35

Anijet me 600 tonë karburant, deputeti Braçe: Ndiqni naftën, të kuptoni kush është mafia e kontrabandës nga Afrika Veriore! Hetoni më tej, trafiku lumë
16 Janar, 15:31

Lushnjë/ Ndalohet 35-vjeçari në fshatin Dushk, kanosi me armë zjarri të riun pranë banesës së tij (EMRI)
16 Janar, 15:27

Status strategjik për parkun industrial 'Vertigo' në Xhafzotaj në Durrës
16 Janar, 08:01

S'u sekuestruan 1 mijë, por 600 tonë naftë kontrabandë në Porto Romano! Prokurorja e Durrësit saktëson sasinë e kapur! Lihen në burg 2 kapitenët e 2 anijeve
Artur Korriku
15 Janar, 18:24

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje